

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"EM - 67" SH.P.K.**

Sot me date 02.12.2021, me ane te ketij dokumenti, te hartuar ne 4 (kater) kopje origjinale, ortaku i shoqerise:

**Z. Enea Strataj**, i datelindjes 02.08.1999, lindur ne GRC dhe banues ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. **B17101242**, dhe numer personal **J90802067M**;

deklaroj se aktiviteti i shoqerise "**EM - 67**" **Sh.p.k.**, do te rregullohet, organizohet dhe zhvillohet ne perputhje me kerkesat e Ligjit, Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Ky Akt-Themelimi dhe Statuti bashkalidhur jane pregatitur konform kerkesave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**1. KOHËZGJATJA E AKTIVITETIT**

Kohëzgjatja e aktivitetit tregëtar të shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pacaktuar.

**2. OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Dhenie e ambienteve me qira, marrje e ambienteve me qira
- Ofrimi i shërbimeve ne fushen e marketingut.
- Ofrimi i shërbimeve ne fushen e ushqimit nepermjet restoranteve, embeltoreve, fast food. etj.
- Kryerje operacioni si ndermjetes tregtare, ne operacione te ndermjetsise ose te spedicionit si dhe ato te perfaqesuesve tregtare.
- Blerja, shitja dhe administrimi i pasurive te paluajtshme te cilat jane ne interes te shoqerise.
- Kryerja e punime ne fushen e ndertimit te objekteve civile, industriale e turistike, prodhimi I materialeve inerte prej guri, rere, cakulli dhe prodhim qeramike, tulle dhe parafabrikate, prodhim e tregtim te elementeve betonarme, prodhim dhe tregtim te materialeve te imeta, te gatshme dhe gjysme te gatshme. Import, eksport, tregti me shumice dhe pakice te pajisjeve te materialve te ndertimit.
- Shitje dhe blerje automjetesh.
- Shitblerja, dhenie dhe marrja me qira e hapësirave publicitare;
- Organizimi i eventeve dhe fushatave te ndryshme publicitare ne fushen e marketingut;
- Realizimi i materialeve promocionale dhe publicitare. Realizimi I printimeve;
- Dhënie dhe ofrim shërbimesh, konsulencë dhe asistencë me staf të specializuar për të tretë për këto çështje dhe pa u kufizuar në to, si mbajtje kontabiliteti, drejtim marketingu, konsulencë ligjore, art dizajn, elektronike etj.
- Shërbime komisioni reklamash, ideim, realizim, prodhim reklamash televizive në mediat elektronike dhe të shkruara.
- Kryerja e shërbimeve te mirembajtjes etj;



Per permbushjen e objektit te veprimtarise, shoqeria mund te marre pjese ne bashkepunim me shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te perafert me te saj in dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet e nevojshme per realizimin e objektit te saj.

### 3. LLOGARIA RRJEDHESE

Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo valuta te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, konform legjislacionit ne fuqi.

### 4. SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga e Limuthit, Gjokaj, ndodhur ne zonen kadastrale nr.1167, numer pasurie 692/21, Vore.

Asambleja si dhe organet e administrimit, kane kompetence te hapin filiale e agjensi te tjera dhe t'i mbylle, sipas cmuarjes dhe gjykimit, qe ato i bejne cdo rasti.

### 5. KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise i nenshkruar dhe i paguar perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte 10,000.00 leke. Ky kapital eshte i ndare ne 1 kuote (nje) kuote me vlere nominative 10,000.00 leke. Kuota ne perqindje e ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte si me poshte:

- **Z. Enea Strataj**, zoteron 100 % (njqind perqind) te kuotave e barabarte me shumen 10,000.00 leke.

Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali themeltar, vlere e kontributit dhe kuota e ortakut te vetem.

Ortaku mund ta zmadhoje kontributin e tij dhe si pasoje edhe kuoten e tij, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerise, konform asaj se parashikuar ne Statutin e shoqerise.

### 6. ADMINISTRATOR I SHOQERISE

Administrator i shoqerise i emeruar per nje periudhe kohe 2-vjecar, me te drejte riemerimi eshte **Z. Enea Strataj**, i datelindjes 02.08.1999, lindur ne GRC dhe banues ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. **B17101242**, dhe numer personal **J90802067M**;

Ai ka te drejten e firmes dhe te perfaqesimit te shoqerise. Asambleja e Pergjithshme ka te drejte te emeroje edhe Administratore te tjere.

Administratori gezon kompetenca te pakufizuara per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe jane ngarkuar asamblese se pergjithshme.

Ne permbushje te detyres se tij mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke emeruar avokate e duke leshuar prokura ne raste gjyqesh, te kryeje operacione bankare, perfshire ketu edhe hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher-xhirimi, tituj krediti, paradhenie krediti.

Administratori ne perfundim te cdo viti ekonomik perpilon nje relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektiven e shoqerise, si dhe pergatit bilancin

perfundimtar qe ia paraqet cdo vit Asamblese per aprovim. Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne perfundim te vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, Asambleja pasi ka ndare fondet per likuidimin e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos per ndarjen e fitimit neto. Per humbjet pergjigjet eskuzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

## 7. KONFIDENCIALITETI

Ortaket dhe Administratori jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjeserisht.

Ata jane pergjegjes per pasojat negative qe mund te vijne nga shkelja e dispozites se mesiperme. Sa me siper vlen edhe edhe per Ekspertin Kontabel te Regjistruar.

Ortaket jane pergjegjes, ndaj te treteve per demet qe mund t'u shkaktohen nga anulimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelues.

Per sa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, do të zbatohen parashikimet e Statutit bashkangjitur.

Njekohesisht me nenshkrimin e ketij Akti, ortaku nenshkroi edhe Statutin e shoqerise "EM - 67" Sh.p.k., i cili i bashkalidhet aktit te themelimit dhe eshte pjese perberese e tij.

**ORTAKU I VETEM**

**ENEA STRATAJ**

*Enea Strataj*  
